



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10095 Prot.

Roskovec, më 27, 11 2025

VENDIM

NR 62. DATË 27. 11. 2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN TETOR 2025”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.10.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Tetor 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9463/1 Prot.

Roskovec, më 31.10.2025

Procesverbal Nr.10

-I mbajtur sot, datë 30.10.2025, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2025.
5. Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Roskovec 2025-2030.
6. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰²

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, F.Feleqi, E.Kaçeli.

Këshilltarët që mungojnë: Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, V.Çepele, A.Pelo, S.Bibo.Qamili.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik O.Goga, Dr.Mbrojtjes Civile A.Dukaj, P/Shërbimit Social E.Kola.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltar. Kryetari –përshëndetje të nderuar këshilltar, faleminderit që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Roskovec, mbledhje për muajin Tetor 2025. Duke qënë se kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e kësaj mbledhje në këtë sallë është i pranishëm, janë të pranishëm 14 këshilltar, gjithashtu dhe përfaqësuesit nga administrata janë të pranishëm, unë e deklaroj këto mbledhje të Këshillit të Bashkisë të hapur. Jeni njohur në datën 24 me vendimin e Kryesisë së Këshillit për rendin e ditës së kësaj mbledhje. Ky rend dite është shpërndarë tek ju bashkë me materialet përkatëse dhe nuk ka asnjë ndryshim, kështu që ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni rendin e ditës së mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2025.

Kryetari-do i lutem Sekretares që të na japi një informacion të shkurtër mbi vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2025. Sekretarja- përshëndetje të nderuar këshilltar. Ju në mbledhjen e fundit të datës 30 Shtator keni miratuar gjithësej në total 8 vendime, nga të cilat 2 prej tyre kanë qënë vendime me karakter normativ, të cilat i kemi nisur në Prefekturë për verifikim ligjor. Të 2 vendimet janë miratuar nga Prefektura. Të gjitha këto vendime janë shpërndarë në zyrat e administratës së Bashkisë për zbatime të mëtejshme.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- jeni njohur të gjithë me procesverbalin të mbajtur në mbledhjen e kaluar të Këshillit Bashkiak, ka ndonjeri diskutim sa i takon procesverbalit, jeni njohur me të besoj. Nuk ka. Kryetari-atëherë ju ftojë të votojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2025.

Kryetari-i nderuar z.Jorgo mendon që të dëgjojmë relacionin apo jeni njohur tashmë me këtë projekt-vendim dhe vazhdojmë me procedurat? Jorgo-meqënëse janë pika të pakta ta dëgjojmë. Kryetari-pra për pikën e 4, për ndihmën ekonomike. Jorgo-ka ndryshime? P/Shërbimit Social Enkeleda- ndryshim është vetëm 1 familje në Njësinë Administrative Kuman, janë dy persona të moshuar, ky është ndryshimi i vetëm këtë muaj. Amarildo-nuk është nevoja për ta relatuar. Kryetari-për pyetje dhe për diskutim kërkon njeri fjalën në lidhje me këtë projekt-vendim? Pyetje dhe diskutime nuk kemi kërkesë fjale, atëherë ju ftojë të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin "Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2025". Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

5.Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Roskovec 2025-2030.

Kryetari-është përgatitur një plan vendor, në plotësim të të cilit është mbajtur dhe një dëgjese publike në sallën e Këshillit. Unë ftojë këtu specialistin që të na bëj një relativitet. Në këtë moment vjen këshilltarja E.Kaçeli, ora 13⁰⁷, prezent tani në sallë janë 15 këshilltar. Kryetari-atëherë z.Arben Dukaj do na bësh një relativitet të shkurtër, përmbledhtas për këtë projekt-vendim, ju lutem

ta dëgjojmë. Dr.Mbrojtjes Civile Arbeni- plani vendor i emergjencave civile është në kuadër të zbatimit të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Në zbatim të ligjit është miratuar plani vendor kombëtar para 2 vitesh. Në zbatim të planit vendor kombëtar është miratuar po nga Këshilli i Bashkisë vendimi Nr.11 datë 28.02.2025 “Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut” dhe pas saj sillet për diskutim plani vendor i emergjencave civile. Për planin vendor të emergjencave civile të Bashkisë Roskovec kanë punuar studio gati dy vite dhe është material goxha voluminoz. Para se të miratohej janë bërë një sërë dëgjësash me grupet e interesit dhe këtu në sallën e Këshillit të Bashkisë. Unë faktikisht kam përgatitur një material 13 faqe të përmbledhur, po kam përgatitur dhe një material tjetër pak më të shkurtër, dhe besoj pak a shumë jeni njohur me të dhe në qoftë se ashtu po i hyj materialit prej 13 faqe që është relacion i përmbledhur. Ky dokument i përgatitur për prezantim në Këshillin e Bashkisë i përmbledhur në disa pika kryesore, qëllimi dhe objektivat : Plan i ka për qëllim mbrojtjen e jetës, të shëndetit publik, minimizimin e dëmeve materiale dhe mjedisore si dhe garantimin e rimëkëmbjes së shpejtë për çdo emergjencë civile. Objektivat përfshijnë mbrojtja e jetës, shëndetit të banorëve, parandalimi i dëmeve në pronë e mjedis, forcimi i kapacitetit, reagimit të Bashkisë, rritja e ndërgjegjësisë së publikut, sigurimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimi efektiv. Kuadri ligjor siç e përmenda më lartë është plani vendor i emergjencave civile, ligji për mbrojtjen civile, strategjia kombëtare e zvogëlimit të riskut ndaj fatkeqësive 2023-2030. Strukturat përgjegjëse që përfshijnë Komisionin e Mbrojtjes Civile, ndërsa është miratuar në Shkurt strategjia e vlerësimit të riskut në Bashkinë Roskovec dhe këtu janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që përfshijnë Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel bashkie, drejtuesi operacional në nivel bashkie..Elmazi-ne grupi ynë pasi e diskutojë atë punën e atij materiali, nuk kishte asnjë lloj vërejtje, kush ka nga opozita ndonjë vërejtje ose sqarim le tja bëj pyetje. Kryetari-atëherë propozimi juaj është për mos të dëgjuar relatimin as të shkurtuar që ka përgatitur specialisti. Fredi-ler ta dëgjojmë të shkurtuar, se të gjithë e kemi por të përmbledhur. Jorgo-për mbrojtjen civile sikur duhet të flasim apo jo? Maksi-ju keni miratuar riskun jo mos të miratoni planin vendor. Kryetari-ju lutem, po vazhdojmë të dëgjojmë relacionin. Jorgo-po prandaj po them unë, se të kërkojmë diçka që e kemi dëgjuar dhe mos ta dëgjojmë sikur nuk vete..Arbeni-Bashkia Roskovec përballet me 6 risqe kryesore : përmytja që është zona fushore, rrëshqitjet e dheut që është zona kodrinore, zjarret në pyje në territoret që kanë sipërfaqe me pyje dhe ullishte, tërmetet larg qoftë, rreziqe teknologjike siç ishin shpërthimi i puseve në 2015 dhe epideminë siç kaluam një situatë kaq të vështirë siç jeni në dijeni. Masat parandaluese dhe gadishmëria, masat përfshijnë mirëmbajtjen e kanaleve kullues, sistemi i paralajmërimit të hershëm, trajnimi për stafin dhe komunitetin, identifikimin e zonave të sigurta dhe zhvillimin e stërvitjes paraprake për emergjencat civile. Përgjegjësitë dhe rimëkëmbja, aktivizimi i qendrës operacionale të emergjencave në Bashki, për koordinimin e veprimit të shpëtimit dhe ndihmës, rikonstruksioni i infrastrukturës, mbështetja e familjeve të dëmtuara. Komunikimi me publikun realizohet përmes kanalit zyrtar të Bashkisë, të mediave lokale. Bashkia punon ngushtë me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me Prefekturën, Organizatat Ndërkombëtare. Përfundimi : plani është një instrument strategjik për forcimin e aftësisë ripërthithëse të komunitetit, studimi i risqeve dhe sigurimi i një reagimi të koordinimit ndaj emergjencës. Jorgo-këto emergjencat janë për kë vit? Arbeni-është plani i emergjencave 5-vjeçar, minimum 5, ishalla sdo të kemi nevojë. Çdo vit përshembull tani në Nëntor do përgatisim materialet për emergjencat civile për situatën dimërore larg qoftë përmytjet, ndërsa në Mars ose Prill përgatitet materiali dhe plani i veprimit për periudhën e zjarreve. Këto janë afatshkurtër 6 mujor po ky është një plan që është i përgatitur nga

studio dhe është i parashikuar për minimumi 5-vjeçar. Jorgo-në këto vite çfarë ka ndodhur dhe çfarë kemi bërë ne si Bashki? Arbeni-në këto vite fatmirësisht duke përjashtuar periudhën e kovidit pandeminë, ka qënë në 2015 që ka ardhur nga proceset teknologjike të naftës, që ka qënë shpërthimi në Marinëz, kemi pasur vetëm disa raste sporadike si rrëshqitjet e dherave siç ka ndodhur te kjo rruga e Gogallarëve. Maksi- kemi pasur dhe problematika të lumit Seman, daljet e lumit Seman, kemi bërë panelet..Jorgo-Maksi po ai është specialist..Maksi-të lutem z.Gogo, po e plotësoj. Jorgo-nuk është i aftë të flasi? Maksi-po e plotësoja Gogo, më fal ndjesë. Jorgo-në qoftë se Nënkryetari di më mire, hajde të flasi Maksi dhe mos flisni ju. Maksi-po jo nuk flas unë, po e plotësoj..Kryetari- Maksi të lutem mos të bëjmë replikë dhe të vazhdojmë sepse është boshe. Arbeni-realisht skemi pasur problem me përmbytjet që të kenë qënë në qendër të vemendjes pavarësisht investimit që ka bërë Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, pavarësisht investimit që ka sjellë Ministria e Bujqësisë, pavarësisht investimit që ka bërë Bashkia Roskovec, janë bërë mbi 10 panele të mbrojtjes së lumit Seman. Maksi-të shtojë edhe një une Afrim, ka mundësi? Kryetari-po, fjala është për z.Maksi. Maksi-në këtë kuadër pavarësisht se është miratuar strategjia, kemi pasur problematika të tjera sidomos me rezervuarin qoftë me Kurjanin, me rezervuarin e Ngjeqarit, kemi marr masa për sigurimin e digave që ka qënë një nga detyrat meqë po plotësojë Benin, do më falësh. Kryetari-faleminderit të dyve por të dyja këto çështje nuk kanë të bëjnë me projekt-vendimin, projekt-vendimi është për planin çfarë do bëjmë dhe nuk jemi në llogaridhënie, kështu që të ndalojmë sa më pak..urdhëro fjala është për ju z.Jorgo. Jorgo-kam të drejtën e replikës. Kryetari-sigurisht. Jorgo-më kujtove rezervuarin e Kurjanit, sa është investuar në atë rezervuar dhe çfarë masa nuk janë marr në atë? Kryetari-Jorgo do të kërkoj në fakt mirëkuptimin tënd për ta riformuluar pyetjen, unë do doja më mirë dhe isha më i interesuar se çfarë është parashikuar në këtë plan për rezervuarin e Kurjanit sepse jemi më koherent. Jorgo-Nënkryetari e nxori si problem në rezervuarin e Kurjanit, kur ne Bashkia e Roskovecit ka investuar një kapital shumë të madh në rezervuarin e Kurjanit. Kryetari-që mos të dalim nga projekt-vendimi unë mendoj që..Jorgo-jo është fjala e Nënkryetarit, unë po përmend fjalën e Nënkryetarit. Kryetari-ok, doni një përgjigje nga Nënkryetari? Jorgo-po, se është investuar dhe pse qënka problematik rezervuari i Kurjanit, ku ne si Bashki kemi investuar një kapital. Maksi-përgjigja e parë ishte për të plotësuar Benin, ndjesë në qoftë se ju e morët për keq dhe Benin por ti nuk ma more për keq, për arsye se ishte pyetja juaj u përgjigja me korrektësi për të dyja problemet që shtruat, kush janë difektet që kemi pasur ne për emergjencat civile dhe çfarë masash janë marr, u tha nga z.Arben, njëkohësisht dhe unë shtova diçka. Përsa i përket pyetjes së dytë që thashë për marrjen e masave për digat, është njëri nga risqet që kemi ne si Bashki. Rezervualet zakonisht kanë diga dhe digat kur nuk merren masat përgatitore, masat mbrojtëse ato dhe mund larg e tutje mund të shpërthejnë. Në këtë kuadër thashë kemi marr masa dhe për digën e Kurjanit dhe për digën e Ngjeqarit në Stan. Tani përsa i përket investimeve ky është informacion nuk ka të bëjë me këtë, me investimet për rezervuarin e Kurjanit. Është një rezervuar i ndërtuar në vitet para 90-tës, mban një kapacitet shumë të madh uji 33 milion m³ një herë e një kohë, sot për arsye të problemeve gjeografike dhe problemeve të tjera të klimës e të tjera me radhë, ai rezervuar sot është mbathur dhe ka pak më shumë se gjysmën e sasisë që mund të rezervojë njëherë e një kohë, nga 33 rreth 40,60,70%,65% të kapacitetit që ka pasur në atë kohë. Bashkia së bashku me fondet e qeverisë shqiptare ka filluar rehabilitimin e ish stacionit të pompimit për mbushjen e rezervuarit të Kurjanit. Jorgo-nuk po flasim për mbushjen, po flasim për sigurinë e rezervuarit të Kurjanit. Maksi-për digën e rezervuarit të Kurjanit janë marr masat për të vënë në funksionim portat e digës. Jorgo-sa është investuar? Maksi-po tani unë skam ardhur sot

këtu, të lutem në qoftë se ke pyetje, ama di që janë marr masat që ato portat që nuk hapeshin prej vitesh, Bashkia edhe me investimin e Këshillit të Bashkisë kuptohet, janë vënë në funksionim sot të gjitha portat dytësore dhe portat kryesore që hapen për digën dhe ato të sigurisë. Jorgo-sa është investuar? Maksi-po ta thashe pra që nuk jam i përgatitur sot të jap shifra, se pastaj do thuash nesër sma dhe saktë. Jorgo-në rezervuarin e Kurjanit janë investuar nga Bashkia. Maksi-po mirë ju e dini. Arbeni-po shifrën sta jep dot, unë e di që nga 2019 është bërë një investim...Jorgo-ka garanci në atë investim që është bërë? Maksi-po. Jorgo-po pse del si emergjencë sot? Maksi-po nuk është emergjencë Gogo. Arbeni-jo nuk është emergjencë, ndërkohë rezervatet janë në kuadër të emergjencës për verifikimin dhe kontrollin e digave që mund të krijoj një çarje, një plasaritje, ajo do ketë monitorim të vazhdueshëm. Jorgo-është mundësia radhës tjetër na jepni investimin që është bërë? Arbeni-po, muajin tjetër në seancën tjetër ta jap atë investim që është bërë në 2019 për rritjen e sigurisë së digës, rritjen dhe ndërtimin e mekanizmit të ri se janë me mekanizëm të ri të dyja portat e shkarkimit, është restauruar komplet porta e katastrofikut dhe në qoftë se do unë shkoj dhe për 5 minuta ta gjejë vlerën totale. Jorgo-radhës tjetër dua një shpjegim, investimet që janë bërë. Arbeni-patjetër. Kryetari-po patjetër, kërkesa juaj u sekretua. Arbeni-plus investimi që po bëhet për rritjen e sigurisë së digës dhe ndërtimin e stacionit të Matkës dhe Hoxhenjve, ka përsëri një riparim të pjesshëm të sigurisë së digës në pjesën e Strumit. Rezervuari i Kurjanit është në administrim të Bordit të Kullimit nuk është i Bashkisë, ne kemi në administrim vetëm rezervuarin e Ngjeqarit. Fredi-nuk do ishte më mirë që në planin vendor të emergjencave civile të shtohet dhe një pikë risku..Arbeni-është miratuar në Shkurt strategjia e riskut. Fredi-sepse 3 vitet e fundit dhe parashikimet e meteorologëve shikohet që thatësitat kanë arritur ekstremin, të ishte shtuar një pikë risku e thatësirave se mbase do merren për vaditje për këto, sepse risk siç është përmbytja është risk dhe thatësira, një e para. E dyta, mbase ska lidhje po afërsisht këtu jemi me këtë rend dite, ne kemi për zbatimin e emergjencave civile një grup zjarrfikësish, me ça kam parë unë në rrjete sociale ata kanë ngelur pa paguar, dhe ne miratojmë një plan 5-vjeçar këtu gjithë ato letra, gjithë ato shpenzime që do firma, studime, lekë e gjithë ato gjëra dhe nuk paguajmë zjarrfikësit për orët e punës të prapambetura, më duket shumë absurde. Më mirë para se të miratojmë këtë, miratojmë sot një ti japim lekët atyre se gjynah digjen në zjarr jo për këtë zonën tonë por janë djegur edhe në bashki të tjera, në emergjenca të tjera, është turp, është shumë absurde. Është e vërtetë apo nuk është e vërtetë sepse Bashkia nuk është prononcuar për këtë, në qoftë se është e vërtetë përpara se të miratojmë këtë plan, miratojmë pagat e prapambetura, orët e prapambetura që janë djegur ata të shkretët. Maksi-për pyetjen e parë përse i përketë thatësisë sipas parashikimeve që duhet të ketë problematika dhe për vaditjen nesër, është marr masa në rezervuarin e Ngjeqarit që është bërë furnizimi edhe nga përroi lart dhe kjo është mundësia e vetme për të siguruar ujë për vaditje në këtë rezervuar për momentin. Ndërsa përse i përketë asaj që Beni përmendi pak më para, janë marr masat po të njëjtën gjë që nga lumi Seman do të furnizohet rezervuari i Kurjanit, është investim i tanishëm i cili është në përfundim, do të na japi shumë rezultat në furnizimin me ujë vaditës fermerëve, duke filluar që nga Kumani deri në Velmish dhe Strum. Përse i përketë pastaj pyetjes tuaj që nuk ka të bëjë me këtë, me emergjencat, sa i përketë stacionit të zjarrfikëses, pagesat e tyre janë pagesa nga grandit dhe vijnë nga qeveria shqiptare..Fredipo për orët shtesë? Maksi-për orët shtesë është bërë pagesa e tyre para 3 ditësh në mos gaboj, për orët shtesë se zakonisht orët shtesë janë gjatë periudhës së verës Qershor, Korrik, Gusht qoftë dhe Shtator prandaj dhe ne i mbledhëm të gjitha orët shtesë, ua kemi dhënë të gjitha..Fredijo shumë mirë sepse ishin pa paguar. Maksi-në qoftë se ke parë nëpër rrjetet sociale një problem tjetër..Fredia paska qënë problem. Maksi-nuk ka

qënë problem sepse i kemi mbledhur, e kemi sqaruar. Fredi-po vet zjarrfikësit e kishin deklaruar se kisha deklaruar unë. Maks-i ai ka një problem tjetër, doli vendimi i qeverisë dhe në bazë të vendimit të qeverisë është bërë në rregull, vendimi i qeverisë ka dalë në fund të Shtatorit në mos gaboj, nuk kemi kaq vonesa sa të jetë shqetësuese. Fredi-është zgjidhur, ska problem ajo punë. Në lidhje me atë, nuk është vetëm vaditja, mbase prek vetëm vaditjen dhe ajo është e evidente nga thatësira po u prek se janë 330 familje në fshatin Ngjeqar, e di ç'është emergjence është përshembull nga thatësira pa ujë? Më emergjencë se kaq, hodhi armiku e kupton, ku do pijë ujë ata 330 familje, me emergjencë se kaq nuk ka. Arbeni-i nderuar këshilltar bashkë kemi biseduar dhe para 1 viti, unë bashkë me specialistët që ka marr Bashkia Roskovec i kemi rënë cep e më cep për të gjetur mundësinë e ndërtimit të ndonjë ujësjellësi apo pusi në Ngjeqar, është një lloj formacioni të tokës dhe për këtë të mbaj leksion gjithë ditën, që janë fishe argjilore dhe janë të papërshtatshme për ujin e pijshëm. Fredi-ka mundësira të tjera plotë. Arbeni-do ta them dhe atë mundësinë tjetër, dhe nuk është gjetur asnjë pikë e përshtatshme dhe asnjë mundësi për të hapur një pus për të furnizuar banorët e fshatit Ngjeqar. Ne po bëjmë përpjekje dhe unë nga ana profesionale dhe me kolegët e mi për të gjetur një mundësi. I kemi rënë rreth e qark dhe nuk kemi gjetur mundësi për të furnizuar me ujë. E kemi merak edhe ne që fshati Ngjeqar pavarësisht që konsumon ujin e pusit por teknikisht është i papërdorshëm se janë fishe argjilore dhe ka shumë element bakterologjik që nuk mund ta përdorni. Jorgo-po zona përreth? Arbeni-kemi shkuar deri lart se tani si di fshatrat me radhë, e kemi parë, nuk është..Leksi-po në këto kushte çfarë mund të bëhet, do zhvendoset fshati po nuk pati ujë? Jorgo-ata njerëz nuk duhet të pijë ujë? Arbeni-jo duhet të pijë por..Leksi-opo të jetë për përdorim pa për të pirë..Fred-i-ka mundësira sepse ti e di që ka mundësira, në Lofkënd vjen uji, në Cër po vjen uji, në Aranitas po vjen uji nga Poçemi, një tubacion ore gjithë ai shtet. Para fushatës zgjedhore u premtua, epë thashë shqyrtë hajt se meqë ishte Ministria përkatëse hajt se do ta bëj, pruri dhe ca tubacione aty, epë shqyrtë thashë..Maksi-ne i jemi drejtuar Institutit Hidrogeologjik të Tiranës. Fredi-jo jo të kuptoj, e di dhe unë, dhe atë që thote ai e di, nga Poçemi o burrë le të vij..Maksi-tani shiko nuk janë çështje dëshirash këto punë..Fred-i-po mirë po squa fëmija, ju si Bashki..Maksi-janë çështje projektesh dhe preventivash përkatës. Fredi-mirë, mirë po të dojë është gjithë ai shtet. Arbeni-tju tregoj një kurjozitet, nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizime u kanë kërkuar që të vij nga Varibopi, ishte e paarritshme, kam asistuar unë që të vij dhe është e paarritshme. Jorgo-nga Varibopi themi nuk është e mundur, po kjo zonë do ja thajmë gurmazin ne atyre, sdo i japim një pikë ujë, këta janë taksapagues të zonës tonë..Kryetari-janë absolutisht..Jorgo-ne e marrim nga Poçemi ja biem Fierit..Arbeni-jo e ke gabim informacionin, Kafaraj. Jorgo-hë pra dhe Poçemi dhe Kafaraj. Arbeni-jo Poçemi ska, vetëm me bote, ç'bie ndonjë bot, tani e njoh mirë këtë fushë. Maksi-jo i ngatërron ca gjëra, Poçemi furnizon Ballshin, Varibopi Patosin, Kafaraj Fierin..Jorgo-dale dale 3 veta ju asnjëri se merr vesh..Maksi-se marrim vesh ne? Jorgo-se marrim ne se po flisni 3 veta..Maksi-nga Poçemi furnizohet Ballshi, nga Varibopi furnizohet Patosi dhe nga Kafaraj furnizohet Fieri. Jorgo-po dakort, po këtë zonë, nuk e marrim dot ne nga Poçemi dhe ti japim ujë të lagin buzën këta njerëz? Maksi-nuk është çështje dëshirash ta ktheva përgjigjen, ne kemi dëshirë për ta zgjidhur këtë punë, Fredi e tha e mori përsipër Ministria për ta zgjidhur..Jorgo-ore lëre ç'tha Fredi, më dëgjo, tani këta njerëz duhet të lagin buzën, të pijë një godë ujë? Ore kjo zonë paguan, është pjesë e këtij komuniteti, këta nuk kanë të drejtë të pijë ujë? Pse? Zona nuk ka, ka mundësi alternative që mund ti japim ujë kësaj zone. Maksi-është bërë detyra e projektimit, u është dhënë specialistëve të Institutit Hidrogeologjik të Tiranës për të bërë një zgjidhje, kjo nuk është politike..Jorgo-lëre politike, pse e

hap politike ti? Maksi-po ti vazhdove tani, do pijmë ujë sdo pijmë ujë..Jorgo-ne po flasim për zonën..Maksi-po për zonën, jemi në rrugën për ta zgjidhur. Jorgo-nuk po flasim për politikë, po flasim për këta njerëz, duhet të pijnë një pikë ujë..Maksi-po ça është kjo, jetësore? Jorgo-të pijnë një pikë ujë, politike? Maksi-është jetësore..Jorgo-po mirë është politike, e mirë e lëmë politike, Maksi thotë këta janë demokratë mos të pijnë ujë. Maksi-e thotë ti jo unë. Në sallë ka diskutime midis Jorgos dhe Maksit. Kryetari-z.Maksi të lutem ti shmangim replikat e kota. Jorgo-unë po them është jetësore nuk po them politike. Kryetari-ju lutem z.Maksi ti shmangim replikat. Maksi-z.këshilltar kujdes kur të përdorësh fjalën time. Jorgo-janë fjalët e tua, ti e the politike. Maksi-të lutem edhe njëherë, kur të përdorësh fjalët e mia..Kryetari-z.Jorgo nuk është se po të imponohesh në këtë forëm merremi vesh, do të lutem meqënëse mu drejtuat në fillim të fjalës tuaj, unë absolutisht bashkohem me shqetësimin tuaj dhe të them të drejtën është një nga meraqet e mia më të mëdhaja dhe nuk është vetëm ai fshat sepse dhe ai por janë dhe gjithë fshatrat e tjerë, por edhe aty ku ofrohet uji. Ne kemi diskutuar në këtë Këshill disa herë, kemi thërritur këtu dhe përfaqësues të ujësjellës Sh.A Fier sepse dhe uji që ofrohet në pjesën tjetër është ujë komunitar, është ujë komunal sepse për përdorim dhe unë mendoj që jo ata e meritojnë por të gjithë e meritojnë që ta kenë këtë shërbim. Pastaj se cilat janë rrugët e zgjidhjes për këtë unë kam mëdyshjet e mia dhe nuk besoj se është plani i emergjencave për ta zgjidhur, nuk e di nëse do ta trajtojmë si emergjencë këtë gjë dhe që të qëndrojmë brenda rendit të ditës unë do doja që me dakortësinë tuaj në qoftë se doni, që ne ti drejtohem edhe njëherë institucioneve që janë mbi ne, për të parë me përparësi zgjidhjen e këtij problemi. Do isha shumë dakort qoftë dhe në emër të Këshillit por të ngelemi tek projekt-vendimi, do ju lutesha edhe të shmangni replikat se replikat nuk na kanë çuar asnjëherë asgjekundi. Jorgo-unë nuk e pata as politike as ashtu, e pata për këta njerëz. Kryetari-i thashë këto fjalë për të vazhduar mbledhjen sepse nuk mundem që ta zgjidhim në këtë forëm. Jorgo-dakort. Kryetari-faleminderit për mirëkuptimin Jorgo. Fredi-ti thua nuk është emergjente, japim një krahasim të tillë, në qoftë se qyteti i Roskovecit nuk do kishte ujë ditën e sotme, nuk është emergjencë? Pse është Roskoveci këtu dhe është Ngjeqari atje? Më emergjencë se kaq nuk ka. Unë jam dakort me propozimin tuaj, që ne si Këshill të propozojmë, të formulojmë Ministrisë përkatëse, ore më kaq se emergjente nuk ka..Kryetari-po dhe besoj se kemi dakortësinë e të gjithëve. Fredi-absolutisht jam dakort e formulojmë një kërkesë, edhe ju z.Beni ta formuloni, tja propozoni Ministrisë përkatëse se më emergjencë se kaq. Imagjinoje sikur Roskoveci mos të kishte ujë të pijshëm, kaq, më emergjencë se kaq nuk ka, pse është Ngjeqari dhe sështë ajo, pse është ajo 330 dhe nuk është 500, sepse një familje javën e kaluar ka shpenzuar 15 mijë euro dhe nuk e ka çuar ujin. Kryetari- i qëndrojmë kësaj që diskutuam dhe do shikojmë mundësinë patjetër që ti drejtohem. Lexi-ne si Këshill jemi të gatshëm që në çdo kohë të bëjmë një mbledhje..Kryetari-jo mbledhje nuk ka nevojë, ne i kemi thënë mendimet tona këtu, vetëm të formulojmë një material dhe ta nisim. Jorgo-z.Kryetar në vazhdim të propozimit që tha parafolësi, më emergjent se uji i pijshëm nuk besoj që të ketë ndonjë gjë. Kryetari-atëherë ju mendoni që ne mos ta diskutojmë fare këtë projekt-vendim që ka të bëjë me emergjencat e tjera? Jorgo-të shtohet pika që fshatit, zonës ti gjendet një rrugëzgjidhje, siç pimë ne në Roskovec, të pijnë edhe ata një godë ujë, si në gjithë Shqipërinë. Kryetari-nëse është e mundur që planit vendor për emergjencat civile ti shtohet kjo kërkesë apo jo, unë nuk mundet ta jap dot përgjigjen por duke u nisur nga mënyra e formulimit të këtij plani vendor dhe objektivat që ka ky plan vendor, kjo nuk futet tek ato pika që mund të përfshihet në këtë plan vendor dhe në qoftë se..Arbeni-ai është plan strategjik. Kryetari-ju thashë që është plan strategjik dhe nuk është për ato se kemi filluar që nga fillimi i diskutimit se çfarë është bërë dhe jo çfarë do të bëhet. Në

qoftë se ne e vlerësojmë dhe është, unë jam dakort shumë me ju që kjo është një emergjencë, është një emergjencë por nuk është strategji. Strategji do të thotë që në 2030 thotë ti ta fusim këtu në këtë plan strategjik dhe ta diskutojmë që duhet zgjidhur deri në 2030. Unë ju ofrova një zgjidhje që këtë ta diskutojmë..Fredri-meqë thotë specialisti nuk bëhet..Arbeni-e para ky është një plan strategjik për Bashkinë e Roskovecit, ujësjellës-kanalizime nuk varen nga Bashkia e Roskovecit dhe kanë bërë një riorganizim që nuk varet fare nga ne, Bashkia e Roskovecit ka 4% aksione që është e papërfillshme në Ndërmarrjen a Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime të Fierit. Kjo duhet të bëhet problem për dikasteret qendrore, Ministrinë e linjës që të gjejnë një zgjidhje, por nuk mund të përfshihet tek plani. Hajde të ulemi të diskutojmë, ti bëjmë të gjitha shkresat, kërkesat për Ministrinë, për linjën, për Drejtorinë e Ujësjellës-Kanalizime..Fredri-jam shumë dakort. Kryetari-atëherë besoj se mbyllen diskutimet në lidhje me këtë projekt-vendim. Ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Roskovec 2025-2030”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 15 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për diskutimet dhe votimin.

6.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Kryetari-ftoj për një raport të përmbledhur znj.Goga drejtoreshën e drejtorisë. Dr.Financës Orgesa-të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak, jemi këtu për të paraqitur projekt-vendimin për miratimin e shpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025. Në mënyrë përmbledhëse po ju paraqes një relacion. Në këtë projekt-vendim kemi përcaktuar transferim të fondeve nga ish njësitë shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Mjedisit, Ndërmarrja e Ujitjes-Kullimit, Pyjeve dhe Mirëmbajtje Rruge dhe Varreza, dhe Qendra Ekonomike e Arsimit. Këto fonde ishin planifikuar për pagat e muajit Dhjetor për punonjës të këtyre njësive shpenzuese, të cilët me strukturën e re në Janar të vitit 2025 kaluan si pjesë e Bashkisë Roskovec. Ky fond ngeli i papërdorur dhe kërkon miratimin tuaj për ta rishpërndarë dhe për ta kthyer këtë në buxhetin e Bashkisë Roskovec, i cili do të përdoret po ashtu për paga dhe sigurimet e këtyre punonjësve. Unë e përmbledha në mënyrë të shkurtuar. Kryetari-kemi ndonjë pyetje sa i takon këtij projekt-vendimi? Fredri-cila është arsyeja e rishpërndarjes sepse ne e kemi miratuar, e kemi planifikuar dhe kush është arsyeja, mosmbledhja e taksave apo ndonjë gjë tjetër? Orgesa-ky ishte një fond i planifikuar për pagat e muajit Dhjetor për punonjës të këtyre ndërmarrjeve. Në Janar të vitit 2025 në të cilin merren pagat e muajit Dhjetor, në strukturën e re të 2025 duke qënë se këto ndërmarrje u shkrinë, këta punonjës u bënë pjesë e Bashkisë Roskovec, pagat dhe sigurimet u paguan nga fondi i Bashkisë Roskovec dhe ky fond i planifikuar ngeli i ngrirë dhe duam që të bëjmë transferimin e këtyre fondeve, të pagave dhe sigurimeve nga ish ndërmarrjet në Bashkinë Roskovec, për ta përdorur përsëri për paga dhe sigurimet e këtyre punonjësve. Fredri-këta si punonjës kanë kaluar në Bashki? Orgesa-kanë kaluar pjesë e Bashkisë dhe janë shkrirë këto si njësi shpenzuese për shkak të ristrukturimit të ri që është bërë në Janar. Kryetari-atëherë për diskutim sbesoj se kemi akoma kërkesë, të paktën asnjë nga këshilltarët nuk ka, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025”. Kryetari hedh në votim

projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro. Kryetari-me të gjitha vota pro miratohet ky proj .kt-vendim, ju falenderoj të gjithëve.

7.Diskutime dhe komente të qytetarëve..

Kryetari-ju lutem edhe fare pak vëmendje do kërkoja përpara sesa ti jap fjalën z.Jorgo që e ka kërkuar fjalën i pari. Do doja që tju lexoj kthim përgjigjen për problematikat e ngritura në mbledhjen e Këshillit. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak datë 30.09.2025 u diskutuan dhe u ngritën problemet si më poshtë: Kryetari lexon sipas radhës problematikat e ngritura nga këshilltarët dhe kthimin e përgjigjeve nga administrata sipas shkresës së ardhur. Në lidhje me problematikën e Emels:- Arbeni –këtë përgjigje e kam dhënë unë z.Kryetar. E kam parë me shumë vëmendje dhe në qoftë se do të kalojë me të vërtetë parkim nga të dyja anët, është e pamundur që të qarkullojnë mjetet, do të krijojë problem..Fredi-atje faktikisht qëndrojnë, parkojnë në të dyja anët, parkojnë jashtë ligjit por parkojnë dhe kalojnë, është e kalueshme. Mund të mos jetë e ligjshme absolutisht ju keni bërë matjet përkatesë, mund të jete por atje sa herë që unë kalojë të dyja anët janë të zëna. Arbeni-e kam parë edhe unë, por normalisht do sillte problem tek trafiku, ka shumë familje që ke poshtë lokalit të Benit të Veliut, ka ato kthesat, nuk mund të bllokohet nga të dyja anët, unë e kam parë me shumë korrektësi. Kryetari-atëherë kjo ishte përgjigja, faleminderit z.Beni. Kryetari lexon problemin e ngritur nga Fredi për vendosjen e një transformatori në rezervuarin e Ngjeqarit dhe një tubacion plastik për furnizimin me ujë, si dhe përgjigjen e administratës e cila e ka marr këtë rast për diskutim. Kryetari-ky rast është për diskutim pra nuk kemi një përgjigje përfundimtare. Fredi-shpresojmë. Kryetari lexon problemin e ngritur nga Nazmiu për çezmat në fshatin Ngjeqar dhe përgjigjen e administratës. Nazmiu- e kuptoj por kur do bëhet tjetra? Fredi-se faktikisht janë miratuar dy. Arbeni-një, në projekt kemi një vetëm tek plepat poshtë, një çezëm është. Fredi-një është miratuar vjet dhe një që se keni marr në dorëzim..Arbeni-ajo është..Fredi-nuk e di sepse ishte Kryetarja këtu kur tha do bëjmë dhe një tek lagja e Nazmiut. Arbeni-dakort, një është. Fredi-edhe mbase..Arbeni-duhet të kesh besim tek unë që është një se ska mundësi për tu bërë tjetër. Nazmiu-në një fshat që ska ujë dhe burime natyrale pse mos të bëhen 2 apo 3..Fredi-5, 7, janë 7 çezma. Nazmiu-në çdo lagje të bëhet me qëllim që ti vijmë në ndihmë komunitetit se ska ujë, kjo është zgjidhja më elementare. Kryetari-jemi në prag të miratimit të buxhetit dhe paketës fiskale, në qoftë se drejtorja juaj e shikon të arsyeshme kërkesën e këshilltarit, ta parashikojë..Në sallë ka diskutime midis këshilltarëve të cilët flasin njëkohësisht. Kryetari lexon problemin e Nazmiut për gabinën elektrike dhe përgjigjen e administratës, të cilët i kanë nisur shkresë bashkëpunimi OSHEE-së. Lexon në lidhje me problemin e Nazmiut për rrjetin elektrik në disa parcela dhe përgjigjen e administratës, të cilët i kanë nisur shkresë bashkëpunimi OSHEE-së. Në lidhje me problemin e ngritur nga Nazmiu për dizifektimin e depove në fshatin Ngjeqar dhe përgjigjen e administratës, e cila e ka përfshirë në projektet prioritare për vitin e ardhshëm rrjetin e ujësjellës-kanalizime për Njësinë Administrative Kurjan, përfshirë dhe fshatin Ngjeqar. Kryetari lexon problemin e ngritur nga vet ai, në lidhje me afatin se kur do të përfundojë rruga dytësore nga fusha e sportit për në lagjen e Shurdhenjve dhe përgjigjen e administratës se punimet kanë përfunduar nga operatori. Kryetari-këto janë përgjigjet e pyetjeve që kemi ngritur..Nazmiu-kam trajtuar dhe një problem tjetër në lidhje me ujin e shkollës, nuk e di gjendjen ka ujë shkolla? Kryetari-këto janë kthimet e përgjigjeve për shqetësimet që keni ngritur. Nazmiu-po pse nuk është marr në konsideratë ajo? Kryetari-të lutem ta shënojmë dhe shqetësimin e z.Nazmi. Sekretarja-po.

Jogro-para 1 viti e gjysëm kam kërkuar një ndërhyrje që duhet të bëhet për fermerët nga rruga kryesore e Marinzës deri në kanalën e tokave, siç më kanë ardhur kërkesat. Sot e kësaj dite, para votimeve janë mbledhur e gjithë zona, kanë dhënë firmat për atë rrugë gjithë fshatarët që punojnë në atë zonë, fermerët dhe sot e kësaj dite nuk është ndërhyrë. Rruga është matan kolektorit, kanali që vjen nga Luari del në Jagodinë, te kryqëzimi për në Marinëz. Po bëj 1 vit e gjysëm që e kam kërkuar unë dhe para votimeve janë mbledhur të gjithë dhe kanë firmosur dhe sot e kësaj dite nuk është ndërhyrë. Pse? Elisabeta Toska-shqetësimi im lidhet me ujërat e zeza, mesa mbani mend që në fund të mujit Gusht i njëjti shqetësim dhe akoma pa përgjigje, kur ndërkohë të gjitha strukturat përkatëse janë në dijeni, madje nuk kanë ardhur as ti shohin tubacionet, situatën, problematikën dhe shkallën e problematikës. Kryetari-të lutem referou pak më saktë për cilën..Elisabeta-lagja e Toskallarëve. Kryetari-për këtë ishte kthyer një përgjigje në mos gaboj në materjalin e mbledhjes së kaluar, por si duket nuk e keni dëgjuar ose skeni qënë deri në fund. Lexi-jo nuk u lexuan ato. Sekretarja-nuk u lexuan se nuk priten. Kryetari-ato filluan të lexohen..Elisabeta-gjithsesi problemi nuk ka marr zgjidhje. Lexi-shpërfillen përgjigjet e të tjerëve dhe nuk i dëgjoni, ajo ishte përgjigja. Elisabeta-ok, e rëndësishme është që problemi nuk ka marr zgjidhje. Maksi-përgjigja ka ardhur dhe sot po punohet tek Limallarët, do vazhdojë edhe aty. Amarildo-besoj se të gjithë këtu janë vënë në dijeni dhe nga mediat, që në Patos-Marinëz po bëjnë një protestë sindikata e naftëtarëve bashkë me naftëtarët. Duke qënë se ne jemi pjesë e Patos-Marinzës dhe Bashkia jonë i takon që të jetë mbështetje me të drejtë e atyre naftëtarëve. Një pjesë dërrmuese e tyre janë pjesë e Bashkisë tonë punonjësit, të paktën punonjësit bazë sepse pjesa dërrmuese e inxhinierëve janë sjellë nga Kina, se na mbaruan inxhinierët ne dhe i kanë sjellë nga Kina, po ky është një problem tjetër. Unë i përshëndes ata naftëtarët bashkë me sindikatën e tyre, për këtë akt dhe vendim që kanë marr, që kanë hyrë në grevë për të drejtat e tyre, për paga dhe dinjitet sepse ata janë të keq përdorur, të keq paguar dhe të keq menaxhuar. Unë do doja duke qënë pjesë Marinza e Bashkisë së Roskovecit, se çfarë ka bërë Bashkia, a ka dërguar Bashkia përfaqësues të saj minimalisht në mbështetje të tyre, për ti pyetur për problematikat që me të drejtë ata kanë ngritur dhe për të qënë mbështetje, sepse ligjërisht ose moralisht ne duhet të qëndrojmë pranë tyre, se ata kërkojnë të drejtat që u takojnë,iu janë mohuar prej më shumë se 20 vitesh. Kjo është përtej partive, thashë edhe njëherë më shumë se 20 vitesh, ne duhet të jemi koshient që në atë fushë kanë qënë të punësuar shumë herë më shumë punonjës seç janë sot. Ajo fushë ka mbajtur me mijëra punëtor, duke qënë ai Patos është formuar nga ajo naftë, dhe Roskoveci ka qënë pjesë e saj e padiskutueshme ndër vite, sot që flasim numri i punonjësve nuk kalon 1 mijë, kjo është e sigurt sepse unë kam qënë pjesë e Bankers Petroleum dhe e di shumë mirë sesa është numri i punonjësve sot aktual. Megjithëse reduktuar kaq që nuk kishte arsye të reduktohej, janë hequr specialistë, inxhinierë shqiptar të formuar, specialistë të vërtetë dhe pagat e tyre nuk janë rritur, u janë ulur, specialistëve i janë ulur sidomos punonjësit e terrenit janë të keqpaguar, dhe unë do të doja një përgjigje nga Bashkia, në rast se atyre nuk u është dërguar përfaqësues është shumë e vonuar, duhet të kishit dërguar sepse ajo grevë ka prej më shumë se 1 javë që vazhdon. Unë kaq kisha, faleminderit. Maksi-greva e urisë gjithmonë kërkon kushtet ekonomike për punën e pagave, di që ka një kontratë pune midis sindikatës dhe punonjësve me kompaninë Bankers, di që kompania Bankers ka ca problemet e veta ekonomiko-financiare, po këto probleme zgjidhen vetëm në problemet e një institucioni përkatës që ka kontratë me punonjësit dhe me kompaninë Bankers. Bashkia nuk është pjesë e këtyre kontratave, nuk është pjesë e vendimmarrjeve. Amarildo-nuk thamë gjë që është pjesë e kontratave, punonjësit kanë lidhur kontrata me punëdhënësin, idea është që çka do bëhet? Maksi-zgjidhen vetëm me gjykatë, në

qoftë se ka problematika që ka konflikte në një kontratë, në pikën e fundit të kontratës thuhet shprehimisht është gjykata ajo që vendos për zgjidhjen e konfliktit. Ne jemi për të atyre, shpresojmë të na dalin mirë me shëndet në të gjitha drejtimet..Amarildo-ta shpërndani Maksimi në qoftë se i keni mbështetur vërtetë, në rrjetet sociale unë skam parë të reagoni fare, minimalisht. Kryetari-faleminderit, tjetër kush? Atëherë asnjë nga këshilltarët nuk e kërkon fjalën për diskutime, qytetar të pranishëm nuk kemi, unë e deklaroj mbledhjen e kësaj dite të mbyllur, faleminderit të gjithëve që ishit të pranishëm.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Afrim Plaka